

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË ÇËRRIK

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Çërrik me objekt: “Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publik, funksionimi i policisë bashkiake, prokurimit me fondet publike, taksat dhe tarifat vendore, etj.”. dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 110, datë 30.6.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 153/6, datë 30.06.2012, dërguar z. **Servet Duzha**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa, që të rishikohet struktura organizative me synim reduktimin e numrit të punonjësve, në përputhje me mundësitë financiare të bashkisë.

Menjëherë

2. Të merren masa, që të rishikohet rregullorja e funksionimit të brendshëm të institucionit me qëllim që të mundësojë detyra të qarta për çdo punonjës dhe njësi të strukturës organike.

Menjëherë

3. Të merren masa, që të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj. sipas kërkesave të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III, pika 30 dhe të kryhet inventarizimi i tyre.

Brenda datës 31.12.2012

4. Të merren masa, që të ndërtohet evidenca kontabël për aktivitetin e furnizimit me bileta dhe abone të linjave urbane dhe të kryhet inventarizimi i këtij aktiviteti, sipas kërkesave të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, pjesa e parë “Rregulla të përgjithshme”, kapitulli i parë “Mbajtja e kontabilitetit”.

Menjëherë

5. Të merren masa, që të kontabilizohen në ditarin përkatës të magazinave vlera prej 1,555,000 lekë për 6 studime e projekte të paguara nga bashkia në vitet 2010 e 2011, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikat 9 dhe 26 të nenit 4, pika 3/dh të nenit 12, pika 2 të nenit 16 dhe pika 5 të nenit 23.

Menjëherë

6. Të merren masa, që Zyra e Taksave Vendore, të hartojë planin vjetor për ushtrimin e kontrolleve në drejtimet e përcaktuara, sipas kërkesave të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”, pika 10.

Menjëherë

7. Të merren masa, që të analizohet lista e detyrimeve të papaguara për tatime dhe tarifa për 12 subjekte në shumën prej 507,119 lekë, të kontabilizohet dhe të fillojë detyrimi i arkëtimit.

Menjëherë

8. Të merren masa, që të planifikohet për vitin 2012 e në vazhdim, tarifa e pastrimit ndaj Enteve Shtetërore në juridiksion të Bashkisë Cërrik si Qendra Shëndetësore, Rajoni i Policisë, etj.

Menjëherë

9. Të merren masa nga Drejtoria e Urbanistikës, për të kryer inventarizimin e dokumentacionit të miratimit të lejeve të shesheve dhe lejeve të ndërtimit, të KRRT-së së bashkisë, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154 datë, 06.11.2003 “Për arkivat”.

Menjëherë

10. Të merren masa për ushtrimin e kontrolleve nga INU në bashki, në lidhje me vendosjen e mbikëqyrësve të punimeve të ndërtimit, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Menjëherë

11. Të merren masa nga INU në bashki, për të detyruar zbatuesit e punimeve, që të njoftojnë zyrtarisht fillimin e punimeve, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Menjëherë

12. Të merren masa nga INU në bashki, për tu kërkuar subjekteve të ndërtimit, planin e organizimit të punimeve në objekt, mbajtja e procesverbalit për gjendjen e masave të sigurimit teknik të punimeve të ndërtimit dhe pajisjen me mjete për mbrojtjen e jetës së punëtorëve, si pjesë e dokumentacionit të dosjes teknike, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshimet e mëvonshme, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Menjëherë

B.MASAT PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkohen në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **378,359 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit si më poshtë:

a. Për ■ 30,752 lekë, që ka përfituar pagese tepër në mbikëqyrjen e punimeve të objektit: “Rikonstrukcion i ujësjellësit të qytetit Cërrik, faza II”, në kundërshtim me kapitullin IV, pika A e VKM nr. 444, datë 5.9.1994 “Për tarifën e studimit, projektimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit” dhe kontratën datë 04.02.2009 të lidhur ndërmjet Bashkisë Cërrik dhe mbikëqyrësit të punimeve.

b. Për ■ 319,167 lekë, që ka përfituar pagese tepër në kolaudimin e punimeve të objektit: “Rikonstrukcion i ujësjellësit të qytetit Cërrik, faza II”, në kundërshtim me kapitullin IV, pika B të VKM nr. 444, datë 5.9.1994 “Për tarifën e studimit, projektimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit” dhe kontratën datë 04.02.2009 të lidhur ndërmjet Bashkisë Cërrik dhe kolaudatorit të punimeve.

c. Për ■ 28,440 lekë, që ka kryer shpenzime për pritje dhe përcjellje, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 243, datë 15.5.1995 “Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhen delegacioneve të huaja”, i ndryshuar.

Menjëherë

C.MASA DISIPLINORE

1. Mbështetur në nenet 37 e 144 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe nenit 35 të kontratës individuale të punës, kërkohet të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejte me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës”

1. Për ■ me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.

- Për mos zbatim të VKM nr. 444, datë 5.9.1994 “Për tarifën e studimit, projektimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit”, kreu IV, pika A, lidhur me kryerjen e pagesave tepër në

tarifat e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objektit “Rikonstruksion i ujësjellësit të qytetit Cërrik, faza II”, në shumën 349,919 lekë.

- Për mos zbatim të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1985 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare", nenit 7 dhe ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pika 3/dh neni 12, pika 2 neni 16 dhe pika 5 neni 23, lidhur me mos bërjen hyrje në magazinë dhe kontabilizimin në ditarin përkatës të magazinave për vlerën prej 1,555,000 lekë për 6 studime e projekte të hartuara nga bashkia në vitet 2010 e 2011.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Jonel Nasto, Josif Lile dhe Selman Hysaj. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT